



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.594/2015

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditëses: nga te cilin e perfaqeson avokat ne sipas autorizimit, kunder te paditurve: l nga fsh. Komuna e dhe nga , r. nr. si dhe nga tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqeson av. ne sipas aktvendimit te kesaj gjykate: baza e kontestit: Vertetim pronesie, viera e lendes se kontestit: 5.000,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.15.03.2018, me dt.14.05.2018 jep kete:

A K T G J Y K I M

-APROVOHET kerkespadia e paditëses: nga dhe **VERTETOHET** se paditesja ne baze te kontrates mbi shitblerjen e dt.30.12.1982 dhe mbajtjes me mirbesim mbi 20 vite eshte pronare e palujtshmerise, ngastren katastrale ZK ne vendin e quajtur „ ” me kulture shtepi – ndertese me siperfaqe prej 102 m2 dhe oborr ne siperfaqe prej 180 m2 , e cila palujtshmeri evidentohet ne emer te , pjesa e prones 1/1 ZK

Detyrohen te paditurit qe t'ia njohin kete te drejte paditëses dhe te njejtës ti lejojn qe paditesja kete te drejte ta regjistroi prane Drejtorise per Gjeodezi dhe Kataster ne ne afatin prej 15 ditesh nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditesja ne padine e parashtuar si dhe ne seancat e mbajtura permes te autorizuarit te saj ka theksuar se: e njejta me 30.12.1982 nga e paditura he motra e saj e ndjera blere palujtshmerine e cekur ne dispozitiv me qmim te shitblerjes prej 42.000.000 dinare te atehershe.

E paditura dhe motra e saj tani e ndjera pronesine per kete patundeshmeri e kane fituar ne baze te aktvendimit mbi trashigimi te forms se prere O.nr. te dt.28.10.1982 , mirepo edhe perkunder kesaj kjo palujtshmeri ende nuk evidentohet ne te padituren dhe motren e saj . Kontrata lidhur me shitblerjen e patundeshmerise u jane djegur se bashku me shtepi gjate luftes ne Kosove.

I autorizuari i paditeses ne seancen e shqyrtimit kryesor theksoj se paditesja para shume vitesh kete palujtshmeri e ka blere nga _____ e ka paguar qmimin kontraktues te shitblerjes, ka hy ne shfrytezim dhe posedim te te njejtës duke mos qene e penguar nga askush dhe se edhe tani te njejtën e shfrytezon pa pengesa. Nga keto fakte del se gabimisht kjo patundeshmeri eshte regjistruar ne emer te _____ i permdryshe ka qene prone ekspluzive e te paditures.

Ne fjalen perfundimtare i propozon gjykates qe padine dhe kerkesepadine e paditeses ta aprovoj si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te paditurve : _____ dhe _____, konform nenit 423.4 te LPK-es.

Te paditurat _____ dhe _____ ne seancat e meherhshme nuk e kontestuan kerkesepadine e paditeses duke theksuar se: ne vit 1982 e paditura _____ si trashigimtare e te ndjerit _____ ket palujtshmeri i aka shitur _____ dhe _____, dhe si eshte rexhstruar ne emer te _____ nuk ka njohuri. Ne tersi eshte paguar qmimi I shitblerjes dhe tani nuk ka asgje kontestuesedhe se _____ thenjet nga kerkesepadia jane te sakta duke i propozu gjykates qe te gjitha seancat e ardhshme te mbahen pa prezencen e te njejtave.

I padituri _____ ne seancen e shqyrtimit kryesor nuk e kundershtoi kerkesepadine e paditeses, thenjet nga e njejta jane te sakta, tani nuk kane asgje kontestuese dhe eshte e vertete se shitblerja ka ndodhe ne kohen dhe menyren sikurse qe eshte pershkruar ne kerkesepadi.

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoi.

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.549/15 te dt.20.09.2017, te paditurit i caktoi perfaqesuesin e perkoheshem av. _____ nga _____ i cili ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtron te drejtat dhe detyrimet konform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkoheshem i te paditurit ne fjalen perfundimtare deklaroi se: i propozoj gjykates qe te vendos ne baze te rezultatit te provave

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme, veproi dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne baze te nenit 8. te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet te vendoset si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne procedure e provave lexoi: Aktvendimin mbi trashigimin te Gjykates Komunale ne O.nr. _____ dt. 20.10.1982, qertifikaten e pronesise _____ e dt.22.03.2017 ZK _____, dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga qertifikatat e pronesise te sipercekura konstatohet se: palujtshmeria tani lendore evidentohet ne emer te _____ .. 1/1 ZK

Nga aktvendimi mbi trashigimin O.nr. _____ i dt. 20.10.1982 i formes se prere, konstatohet se: _____ tani e paditura _____ dhe tani e ndjera _____ jane shpalle trashigimtare ne 1/2 e _____ patundeshmerise pas vdekjes se babait te tyre dhe ate palujtshmerise kat.parc. _____ dhe _____

KK

Nga pohimet e te paditurve dhe me pamedyshje argumentohet fakti se : paditesja me dt. 30.12.1982 nga e paditura dhe motra e saj tani e ndjera trashigimtare te se ciles jane te paditurit dhe , ka blere palujtshmerine tani lendore me qmim prej 42.000,000 dinare te atehershem dhe se ne teresi ka paguar qmimin e shitblerjes, ka hy ne posedim dhe shfrytezim te kesaj palujtshmerie duke mos qene e penguar nga askush te cilen edhe tani e shfrytezon pa pengesa.

Nga provat e zhvilluara gjithashtu u konstatua se : kjo kontrate mbi shitblerje paditeses i eshte djegur se bashku me shtepine gjate luftes ne Kosove . Gjithashtu kjo kontrate mbi shitblerje edhe pse eshte permbushur 100% , kjo patundeshmeri juridikisht gjere me tani nuk eshte bartur ne emer te bleresit .

Ne nje gjendje te ketille faktike te vertetuar me larte, gjykata kerkesepadin e paditeses e aprovoi ne teresi si te bazuar si nen piken I. te dispozitivit te aktgjykimit konform nenit 21 dhe 28 te LTHMPJ-es, Gaz.Zyrt RSFJ nr.6/1980 ne fuqi prej 1 Shtatorit 1980 (neni 90) deri me 20 Gusht 2009 (nenit 296-297 te Ligjit nr.03/L-54) mbi Pronesine dhe te drejtat e tjera sendore (Gaz.Zyrt. e Republikes se Kosoves nr.57/2009 ne Kosove ne fuqi nga 22 Marsi 1989 eshte Ligj I aplikueshem bazuar ne nenin 1.1 (b) te Rregullores se UNMIK-ut nr.1999/24.

Ne baze te nenit 21 te LMTHPJ-es, eshte percaktuar se: sipas ligjit pronesia fitohet nder te tjera edhe me mbajtje.

Ne baze te nenit 28.al.4. te te njejtit ligj, parashihet kalimi I kohes prej 20 vitesh per mbajtesin e ndershem. Ne baze te provave te cekur me larte e duke marre parasysh se kete palujtshmeri paditesja e ka blere qysh ne vitin 1982 e qe nga ky moment paditesja e ka ne shfrytezim te lir gjere me tani, gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditeses dhe ate : ne menyre origjinere , me mbajtje duke filluar qysh nga viti 1982 e gjere me tani, nga se paditesja ka qene mbajtese te ndershem te kesaj palujtshmerie tani lendore, nga se ne anen e paditeses ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronesis edhe ne baze te mbajtjes: mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme dhe shfrytezimi I papengueshem I kesaj patundeshmerie.

Edhe ne baze te nenit 40 te Ligjit per pronesi dhe te drejtat tjera sendore (Ligji nr.03/L-154) eshte percaktuar se: personi I cili me mirebesim e ka 20 vjet ne posedim te panderprere nje palujtshmeri ose nje pjese te saj e fiton pronesin ne te.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore bazohet ne dispoziten e nenit 450.1 te LPK-se.

Nga si tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij akgyykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË

C.nr.594/2015, me dt.14.05.2018

Gjyqtari
Ragip Kadriu

KESHILLE JURDIKE : Kunder ketij akgyykimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves, e permes kesaj gjykate.

DT
ME DT
05.18
S Ho